



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

V E N D I M

Nr. 21, datë 4.3.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VËNDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË
16.12.2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 8 pika 2, fjalët “2 zëvendëskryetarë” zëvendësohen me fjalën “zëvendëskryetarët”.

2. Në nenin 20, pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare-opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)



Shkruan: Delçej Ahmet
Aspirant Shkrimtar Junior
delçej/delchir
04